



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

Në mbështetje të ligjit për "Vetqeverisje Lokale" nr.03/L-040, neni 62, pika 3, rregullorës komunale për subvencione nr. 16- 126422, si dhe duke u bazuar në planin e punës për vitin 2020, Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari shpall:

THIRRJE PËR APLIKIM PËR FARË MISRI

Të drejtë aplikimi kanë :

- Të gjithë fermerët e komunës së Gjiçanit të cilët janë kultivues të rregullt të misrit dhe mbjellin më pak se 1.00 ha me misër.
- Përparsi do të kanë fermerët me kushte të rënda ekonomike dhe që jetojnë në zonat rurale.
- Fermerët përfitues të farës nga DBP, nuk mund të aplikojnë për subvencionin e misrit në MBPZHR prej 1 ha, e më tepër me misër.

Dokumentet e nevojshme:

- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Vërtetimi i tatimit në pronë (origjinal);
- Fleta poseduese mbi tokën për mbjellje (origjinal), aty ku prona nuk është e rregulluar plotësohet **deklarata e noterizuar**;


Në aplikacion të shenohet sipërfaqja e planifikuar për mbjellje të misrit prej 0.20 ha deri në 0.90 ha.

Përzgjedhja e përfituesve do të bëhet nga Komisioni i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari. Nëse nga e njëjta e familje aplikojnë dy e më tepër aplikues, të njëjtit do të refuzohen.

Aplikimi bëhet në Zyrën për Shërbim të Qytetarëve në Gjiçan, prej datës 05.03.2020 deri 27.03.2020

Gjiçan, 05.03.2020

Drejtori i DBP


Ing.i dipl.i Bujqësisë, Ramiz Ramadani